



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:186032

Datë: 16.04.2024

Numri i dokumentit: 05577120

C.nr.1731/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Vegim Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit K.K. dhe H.K. nga P. të përfaqësuar nga av. Filloreta Hoxha Zymberaj, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “ELSIG” me seli në Prishtinë Rr. Tringë Smajli nr.19, të cilën e përfaqëson Valon Alija jurist në kompani, me objekt të kontestit kompensim i dëmit, vlera e kontestit 23,588.60 euro, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor dhe publike me datë 16.04.2024 mori dhe përpiloj këtë:

AKTGJYKIM

I.APROVOHET PJESËRISHT E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit K.K. dhe H.K. nga P. dhe DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “ELSIG” me seli në Prishtinë, që paditësve në emër të kompensimit të dëmit në aksidentin e shkaktuar me datë 11.09.2020, secilit veç e veç t’ia kompensojë dëmin në shumat si vijon:

- Për paditësin K.K.:

Në emër të dëmit jo material:

Për dhimbje fizike, shumën prej.....4,000€

Për frikën e pësuar, shumën prej.....4,000€

Zvogëlim i aktivitetit të përgjithshëm jetësor.....3,000€

Në emër të dëmit material:

Për ushqim të përforcuar, shumën prej.....210€

Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej .....210€

Për shpenzime të mjekimit.....6€

- Për paditësen H.K.:

Në emër të dëmit jo material:

Për dhimbje fizike, shumën prej.....2,000€  
 Për frikën e pësuar, shumën prej.....2,000€

Në emër të dëmit material:

Për ushqim të përforcuar, shumën prej.....70€  
 Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej .....112€  
 Për shpenzime të mjekimit.....3 €

të gjitha këto që të dy paditësve secilit veç e veç për pjesën e tyre të kompensimit, me kamatë ligjore në lartësi prej 8% për pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë dhe atë për dëmin jo material me kamatë të llogaritur nga data e marrjes së aktgjykimit 17.04.2024 e deri në pagesën e tërësishme, kurse për dëmin material me kamatë të llogaritur nga data 28.12.2020 si datë e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II.DETYROHET pala e paditur që paditësve të ua kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në shumën prej 1,593.20 euro në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III.REFUZOHET E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve K.K. dhe H.K. nga P. , mbi shumat e aprovuara me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit K.K. të ia kompensojë dëmin:

Për dhimbje fizike, shumën prej.....3,000€  
 Për frikën e pësuar, shumën prej.....3,000€  
 Zvogëlim i aktivitetit të përgjithshëm jetësor.....1,000€  
 Për ushqim të përforcuar, shumën prej.....420€  
 Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej .....70€  
 Për shpenzime të mjekimit.....40.80€  
 Për rehabilitim fizikal në shumë prej .....150€

dhe paditëses H.K. të ia kompensojë dëmin:

Për ushqim të përforcuar, shumën prej.....70€  
 Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej .....28€  
 Për rehabilitim fizikal në shumë prej .....150€

të gjitha këto që të dy paditësve secilit veç e veç për pjesën e tyre të kompensimit, me kamatë ligjore në lartësi prej 8% për pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë dhe atë për dëmin jo material

me kamatë të llogaritur nga data e marrjes së aktgjykimit 17.04.2024 e deri në pagesën e tërësishme, kurse për dëmin material me kamatë të llogaritur nga data 28.12.2020 si datë e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive dhe në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore në lartësi prej 650.80euro, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

### Arsyetim

Paditësit K.K. dhe H.K. nga P. , përmes të autorizuarës se tyre av. Filloreta Hoxha Zymberaj, me datën 28.12.2020 ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “ELSIG”, me bazë juridike kompensim dëmi, të cilën padi me anë të parashtrësës së datës 15.03.2024 e ka ndryshuar dhe gjykata e ka lejuar ndryshimin me aktvendimin procedural të datës 03.04.2024, në vlerë të kontestit në shumë prej 23,588.60 euro.

### Pretendimet e paditësit

Paditësi, në padi ka deklaruar se me datën ...09.2020 rreth orës 10:30 minuta, në fshatin Vitomericë K-Pejë, ka ndodhur aksident trafiku mes dy automjeteve të udhëtareve kështu që derisa paditësi K.K. po udhëtonte me automjetin e tij të markës VË me targë 03-...BP. Deri tek aksidenti ka ardhur për shkak të mos përshtatjes së shpejtësisë nga automjeti “A” të cilin po e drejton A.S. dhe nga ky aksident kanë pësuar lëndime trupore dhe dëme materiale. Duke qenë se Automjeti “A” të cilin po e drejton A.S. ka qenë i siguruar tek e paditura, paditësi i ka parashtruar kërkesë të paditurës për kompensimin e dëmit nga ky aksident në kuptim të nenit 4 pika 7, të rregullores mbi procedurat e trajtimit të kërkesave për kompensimin e dëmeve që rrjedhin nga sigurimi i detyrueshëm nga Autopërgjegjësia. E paditura, pas trajtimit të rastit e ka pranuar bazën e kërkesëpadisë, mirëpo komisioni për vlerësimin e dëmeve, paditësve, K. dhe H.K., brenda afatit të paraparë ligjor, nuk ju ka dhënë ndonjë oferte për dëme material e as atë jo materiale. Përgjatë seancave dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, mbetem në tërësi pranë padisë kërkesës së saj si dhe precizimin të kërkesëpadisë e dorëzuar me datën 15.03.2024, sipas të cilit ka kërkuar që të detyrohet e paditura Për paditësin K.K.: Në emër të dëmit jo material: Për dhimbje fizike, shumën prej 7,000€, Për frikën e pësuar, shumën prej 7,000€, Zvogëlim i aktivitetit të përgjithshëm jetësor 4,000€, Në emër të dëmit material: Për ushqim të përforcuar, shumën prej 630€, Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej 280€, Për shpenzime të mjekimit, 70.60€ dhe rehabilitim fizikal në shumë prej 150 euro, kurse për

paditësen H.K.: Në emër të dëmit jo material: Për dhimbje fizike, shumën prej 2,000€, Për frikën e pësuar, shumën prej 2,000€, Në emër të dëmit material: Për ushqim të përforcuar, shumën prej 210€, Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej 140€, Për shpenzime të mjekimit 3 € dhe rehabilitim fizikal në shumë prej 105 euro, e të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 %, duke thekuar se provat e administruara është vërtetuar në tërësi baza juridik e kërkesëpadisë, ndërsa sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë së precizuar e njëjta është reale dhe proporcionale me ekspertizën mjekësore të punuar nga ekspertet Florim Bajraktari dhe Muhamet Halitaj, andaj i propozojmë gjykatës që të njëjtën ta aprovoj në tersi si të bazuar, duke vendos konform precizimit të kërkesëpadisë të bere sipas mendimit të vlerësimit të eksperteve mjekësor.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, të cilat i ka specifikuar në shumën prej 2084 euro.

#### Pretendimet e të paditurës.

Gjykata, palës së paditur, me datën 01.08.2023 i ka dorëzuar aktvendimin për përgjigje në padi, ku e paditura këtë aktvendim e ka pranuar me datën 09.08.2023 dhe përgjigje në padi e ka paraqitur me datën 23.08.2023.

Në përgjigje në padi, pala e paditur, padinë e ka kontestuar në tërësi, si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, sa i përket dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e datës 11.09.2020. Sipas pretendimeve të tyre, i kanë trajtuar kërkesat e palëve në procedurë jashtë gjyqësore, me çka ka rezultuar se kanë lëndime të lehta. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk e kanë kontestuar bazën e kërkesë padisë, por e kanë konstatuar lartësinë. Në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i autorizuar i palës së paditur ka deklaruar se mbetemi pranë kundërshtimeve e të gjertanishme duke kundërshtuar edhe precizimin e kërkesëpadisë, sa i përket shumave të kërkuara si shuma shume të larta dhe që nuk janë adekuate për lëndimet e pësuar dhe pasojat e mbetura tek paditësit dhe nuk janë e përputhje me natyrën e lëndimit. Sa i përket dëmit material kërkoj nga gjykata që të aprovohen vetëm shumat të cilat janë të vërtetuara me fatura-kupona fiskal të rregullt, sa i përket kamatës së kërkuar kërkojmë nga gjykata që këtë ta aprovoj nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit tutje. Andaj nga sa u tha deri me tani kërkojmë nga gjykata që ti merr parasysh kundërshtimet tona dhe po ashtu të merr parasysh edhe praktiken gjyqësore për raste të ngjashme, sa i përket shpenzimeve të aprovohet sipas tarifës së OAK dhe suksesit në procedurë.

#### Provat e administruara, vlerësimi i provave dhe baza ligjore

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat si në vijim: Raporti i aksidentit i datës ..09.2020 me numër DR-....20, procesverbali mbi vend shikimin e aksidentit i datës ..09.2020 me numër DR-...20, se bashku me fotografitë e e vendit të ngjarjes, Kopjet e lejes së njoftimit për palët paditëse, Dëftesa e dt.15.09.2020 me numër 045149, Dëftesa e dt. 15.09.2020 me numër 045148, Kuponi fiskal i dt. 01.10.2020 me numër 0002, Kuponi fiskal i dt. 01.10.2020 me numër 0003, Dëftesa me numër 0040024 i dt. 01.10.2020 për K.K., Dëftesa me numër 0040024 i dt. 01.10.2020 për H.K., një faqe me të cilën janë të kopjuar disa kupon fiskal, Njoftimi i dt. 04.10.2021 nga KS Elsig për K.K. dhe H.K. nga P. me numër 1085/20/03, Ekspertizat mjekoligjore e dt. 13.03.2024 përpiluar nga ekspertet psikiatër Muhamet Haliti dhe ortoped Florim Bajraktari për K.K. dhe H.K..

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 7 dhe 8 të LPK-së, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Me propozime të autorizimeve të palëve prova të tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk u lexuan për shkak se për dem material është arritur ujdia gjyqësore kurse raportet mjekësore dhe CD janë konstatuar në ekspertizat mjekoligjore nga ekspertet mjekësor.

Gjatë procedurës gjyqësore rezultojë të mos jetë kontestues fakti se shkaktari i aksidentit të komunikacionit, nga ka rrjedhur edhe dëmi, të ketë qenë i siguruar tek e paditura, me cka nuk ishte kontestuese baza e juridike e kërkesëpadisë, ku pala e paditur nuk e kontestoj asnjëherë bazën e kërkesëpadisë. Në këtë drejtim, gjykata nuk u lëshua në vlerësimin e këtij fakti, e për më tepër, palët ndërgjyqëse për dëmin material kanë arritur ujdin gjyqësor.

Kontestuese gjatë tërë kësaj procedure gjyqësore, ishte lartësia e kërkesëpadisë, ku përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse, kishin pikëpamje të ndryshme në këtë aspekt.

Nga raporti i Policisë i dt. ...09.2020 me numër DR-...../20 dhe procesverbali mbi shikimin e aksidentit i datës ..09.200 me numër DR-...../20, gjykata vërtetoi faktin se deri tek aksidenti në fjalë i datës ...09.2020, kishte ardhur për shkak të mos përshtatjes së shpejtësisë së automjetit (A) i drejtuar nga A.S., i cili me veprimin e tij të pa kujdesshëm dhe të pa sigurt në rastin e kalimit

nga e djathta ne te majte ne anën e kundër te qarkullimit kishte ndikuar drejtpërdrejtë ne shkaktimin e aksidentit te trafikut e dëme materiale dhe te lëndimeve te paraqitura.

Nga fotografitë e vendit të ngjarjes, gjykata vërtetoi fakti se vetura e paraqitur në foto, është vetura e palës paditëse e të cilën ishte duke e vozitur paditësi K., në momentin kur ka ndodhur aksidenti, e tipit VË, me targa 03-....P.

Nga raporti i emergjencës i spitalit Rajonal në Pejë, gjykata vërtetoi faktin se ditën e ndodhjes së aksidentit, paditësi K. dhe H. K. janë paraqitur në emergjencën e spitalit Rajonal të Pejës, me ç ‘rast përpilohet raporti i mjekut në të cilën evidentohen lëndimet që kanë pësuar. Po ashtu në këtë raport është konstatuar se këto lëndime janë të shkaktuara si pasojë e aksidentit në trafik.

Nga dëftesa me nr. 0045148 e dt 15.09.2020 me shumen prej 3.00 euro dhe deftesa 0040024 e dt 01.10.2020 me shumen 3.00 euro për paditesen H.K., vërtetoi se paditësja si fatura për mjekim ka paguar gjithsej 6 euro, mirëpo kërkesën për këtë katëgori e ka pasë për 3 euro, andaj gjykata nuk e ka tejkualuar.

Me deftesa me nr 0045149 e dt 15.09.2020 me shum prej 3.00 euro, deftesa me nr 0040025 e dt 01.10.2020 me shum prej 3.00 euro per paditesin K.K., gjykata vërtetoi se paditësi K., ka paguar shumën prej 6.00 euro në emër të marrjes së tretamnit mjekësor në spitalin rajonal në Pejë.

Me kuponin fiskal me nr. 0002 me vlere 12.50 euro, kuponi fiskal 0003 me vlere prej 23.20 euro, me numër serik GK52204422 gjykata dhe një faqe me te cilën jane te kopjuar disa kupon fiskalm, gjykata nuk arriti të vërtetoi se këta kuponë fiskal, në të cilët vërtetohet se janë bërë disa pagesa për medikamente mjekësore, se cilit paditës i kanë takuar, e në mungesë të sqarimit të këtyre rrethanave nga e autorizuar e paditësve, gjykata nuk vërtetoi asgjë përmes tyre.

Referuar provave të sipërcekura, gjykata u’a ka falur në tërësi besimin, sepse të njëjtat nuk ishin kontestuar nga palët në procedurë, e për më tepër të njëjtat ishin të lëshuara nga organet shtetëore, respektivisht nga Policia e Kosovës, ku procesverbalet dhe fotot e vendit të ngjarjes paraqesin raporte zyrtare, kurse raportet mjekësore janë të lëshuara nga Spitali e të cilat pasqyrojnë gjendjen reale të palës paditëse, ndërsa deftesat poashtu paraqesin dokumente të besueshme dhe si të tilla i kanë shërbyer gjykatës për vërtetim të fakteve të cilat janë paraqitur dhe si vendimtare

në këtë procedurë, si për përcaktimin e bazës së kërkesëpadisë e poashtu dhe për përcaktimin e lartësisë së kontestit.

Me qëllim të vërtetimit të përcaktimit të natyrës dhe shkallës së lëndimeve të pësura nga paditësit në këtë aksident të trafikut, gjykata sipas propozimit të palës paditëse, ka nxjerrë provën përmes ekspertizës, me ekspertë nga lëmia e psikiatrisë dhe ortopedisë. Ekspertët mjekësor dr. Florim Bajraktari ortoped dhe dr. Muhamet Halitaj psikiatër, në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe ekzaminimit direkt që i kanë bërë paditësit, kanë konstatuar se **paditësi K.K.** si pasojë e aksidentit të shkaktuar ka pësuar lëndime trupore që cilësohen si lëndime të rënda trupore, si rezultat i tronditjes së trurit dhe ndrydhjeve të kokës, trupit, sindroma vertikinoze si dhe stresogjen si pasojë e aksidentit. Gjykata në emër të dhimbjeve fizike aprovoj kërkesën në shumën prej 4,000 € që e vlerësoj si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësi, si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të lartë. Dhimbje të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 4 orëve që përfshin kohën e përpunimit të pacientit në repartin e emergjencës të marrjes së terapisë adekuate, dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 3 javësh që nënkupton kohën e nevojshme për tërheqje të inflamacionit post traumatik, kurse dhimbje me intensitet të ulët ka ende e të cilat i shfaqen kohë pas kohe me ndërrimin e kushteve klimatike, sforcimeve fizike, pas të dhënave anamnestike të paditësit. Me rastin e caktimit të kësaj shume, gjykata kishte parasysh faktin se paditësi kishte pësuar tronditje të trurit, që në fakt dihet se është organ vital për njeriun dhe lëndimi i tij paraqet pasoja serioze për shëndetin e njeriut si dhe për një kohë kishte pësuar humbje të vetëdijes. Po ashtu, një rëndësi të veçantë gjykata me këtë rast i ka kushtuar edhe kohëzgjatjes së dhimbjeve që ka pësuar paditësi dhe faktit se të njëjtat ende janë prezentë dhe i ndjen kohë pas kohë.

Referuar frikës së përjetuar nga aksidenti, eksperti psikiatër ka konstatuar se paditësi ka përjetuar frikë primare (parësore) të intensitetit të lartë me kohëzgjatje prej disa sekondave – kjo periudhë është përcjellë me një shtangim afektiv dhe frike nga vdekja e drejtpërdrejtë, frikë sekondare (dytësore) e intensitetit të lartë ka pësuar pas vetëdijesimit në kohëzgjatje prej 3 orësh të përcjella me frymëmarrje të vështirësuar, të rrahura të shpejta të zemrës, dridhje të muskujve djersitja mundim si dhe ankesa të tjera somatike, Frikë sekondare me intensitet të mesëm ka përjetuar në periudhën kohore deri në 4 muaj, të përcjella me çrregullime të stabilitetit psiko fizik: si pasojë e lëndimeve si: indisponim, pagjumësi, kufizim në aktivitete të përditshme jetësore në situata frustative, prag të zvogëluar të tolerancës, frike nga invaliditeti i mundshëm dhe ankesat tjera somatike. Frikë sekondare me intensitet të ulët ka përjetuar në periudhë kohore gjere me 1 vit e

qe është shfaqur gjate kohës kur ka kaluar nga vendi i ngjarjes apo ngjarje qe ja rikujtojnë lëndimin. Duke u bazuar në këto, gjykata është e bindur se shuma prej 4,000 euro, e akorduar si në pikën II të këtij dispozitivi lidhur me frikën e pësuar të paditësit për të gjitha llojet e saj, është adekuate dhe paraqet një satisfaksion lidhur me atë që ka pësuar paditësi. Edhe më këtë rast, gjykata kishte parasysh natyrën e lëndimit që me këtë rast ishte e rëndë, ku paditësi kishte pësuar frikë primare për shkak të humbjes së vetëdijes, si dhe forma të tjera të frikës si ajo sekondare e dytësore me intensitete të ndryshme të sqaruara si më lartë e cila kishte vazhduar deri në 1 vit pas aksidentit.

Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti ortoped ka paraqitur se ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 2 javë për shkak të lëndimeve trupore që janë cekur më lartë. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 3 javë, i pajisur me proteina, minerale dhe vitamina B complex , ushqim me i përforcuar se i zakonshëm. Po ashtu paditësi ka pasur nevojë dhe për trajtim fizikal në kohëzgjatje prej 10 ditë. Eksperti ka gjetur se paditësi ka invaliditet të përhershëm në shkallë prej 3 % (Kapitulli I pare pika 1.2.1 ( Tronditje e trurt e verifikuar ne institucion shëndetësorë brenda 24 ore ) Prandaj për këtë kategori të dëmit është caktuar shuma e kompensimit në lartësi prej 3.000 €.

Sa i përket trajtimit fizikal, edhe pse eksperti ka konstatuar se paditësi ka pasë nevojë për trajtim fizikal, gjykata një kërkesë të tillë e ka refuzuar sepse pala paditëse nuk ka prezantuar asnjë provë materiale me të cilën do të provonte se ka marrë këto shërbime.

Ndërsa për paditësen H.K. si pasojë e aksidentit të shkaktuar ka pësuar lëndime trupore që cilësohen si lëndime të lehta trupore, si rezultat i tronditjes së ndrydhjeve të kokës, trupit. Ndrydhje e gjurit te majte, ndrydhje dhe hematom ne gjirin e djathte. Gjukata në emër të dhimbjeve fizike aprovoj kërkesën në shumën prej 2,000 € që e vlerësoj si shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësja, si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht te larte, dhimbje të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 2 orëve që përfshin kohën nga momenti i aksidentit dërgimi i saj ne spitalin e përgjithshëm ne Peje ku janë bere ekzaminimet e rehabilitimit te saj mjekësorë, dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 3 javësh që nënkupton kohen e nevojshme për tërheqje te inflamacionit post traumatik, kurse dhimbje me intensitet të ulët ka pasur me kohe zgjatje prej 2 muajve gjate ndryshimeve klimatike, sforcimeve fizike. Me rastin e caktimit të kësaj shume, gjykata kishte parasysh faktin se paditësja kishte pësuar lëndime të lehta trupore. Po ashtu, një



rëndësi të veçantë gjykata me këtë rast i ka kushtuar edhe kohëzgjatjes së dhimbjeve që ka pësuar paditësi dhe faktit se të njëjtat ende janë prezentë dhe i ndjen kohë pas kohë.

Referuar frikës së përjetuar nga aksidenti, eksperti psikiatër ka konstatuar se paditësja ka përjetuar frikë primare (parësore) te intensitetit të lartë me kohëzgjatje prej disa sekondave – kjo periudhë është percjellë me një shtangim afektiv dhe frike nga vdekja e drejtpërdrejtë, frikë sekondare (dytësore) e intensitetit të lartë ka pësuar në kohëzgjatje prej 2 orësh të percjelluara me frymëmarrje të vështirësuar, të rrahura të shpejta të zemrës, mundim si dhe ankesa të tjera somatike, Frikë sekondare me intensitet të mesëm ka përjetuar në periudhën kohore deri në 4 jave, të percjella me çrregullime të stabilitetit psiko fizik: si pasojë e aksidentit si: indisponim, pagjumësi, prag me të ulet të tolerancës frustative si dhe ankesa e tjera somatike. Frikë sekondare me intensitet të ulet ka përjetuar në periudhë kohore gjere me 3 muaj e që është shfaqur gjate kohës kur ka dalë në komunikacion apo ngjarje që ja rikujtojnë aksidentin. Shëmtim trupor nuk ka. Duke u bazuar në këto, gjykata është e bindur se shuma prej 2,000 euro, e akorduar si në pikën II të këtij dispozitivi lidhur me frikën e pësuar të paditëses për të gjitha llojet e saj, është adekuate dhe paraqet një satisfaksion lidhur me atë që ka pësuar paditësja. Edhe më këtë rast, gjykata kishte parasysh natyrën e lëndimit që me këtë rast ishte e lehtë, ku paditësja kishte pësuar frikë primare për shkak të humbjes së vetëdijes, si dhe forma të tjera të frikës si ajo sekondare e me intensitete të ndryshme të sqaruara si më lartë e cila kishte vazhduar deri në 1 vit pas aksidentit, e që është shfaqur kur ka kaluar nga vendi i ngjarjes apo ngjarjet që ia kujtojnë aksidentin.

Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti ortoped ka paraqitur se ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 1 javë për shkak të lëndimeve trupore që janë cekur më lartë. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 1 javë, i pajisur me proteina, minerale dhe vitamina B complex, ushqim me i përforcuar se i zakonshëm. Po ashtu paditësja ka pasur nevojë dhe për trajtim fizikal në kohëzgjatje prej 7 ditë. Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka.

Sa i përket trajtimit fizikal, edhe pse eksperti ka konstatuar se paditësi ka pasë nevojë për trajtim fizikal, gjykata një kërkesë të tillë e ka refuzuar sepse pala paditëse nuk ka prezantuar asnjë provë materiale me të cilën do të provonte se ka marrë këto shërbime.

Gjykata ekspertizën mjekësore të ortopedisë dhe psikiatrisë, e ka pranuar në tërësi si të besueshme, me që e njëjta ishte profesionale dhe të argumentuara, po ashtu e punuar sipas

vëllimit të përcaktuar, po ashtu duke ofruar të dhëna lidhur vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Gjykata ka ftuar për sqarime ekspertët mjeko ligjor, psikiatrin Muhamet Haliti dhe ortopedin Florim Bajraktari, të cilët në seancës e datës 14.03.2024, kanë deklaruar: Eksperti psikiatër, ka qëndruar në tërësi pranë ekspertizës së përpiluar dhe mbetet pranë saj, kurse në përgjigjen e të autorizuarës së palës paditëse, lidhe me natyrën e lëndimeve për paditësin Kapllan, ka deklaruar se këto lëndime që ka pësuar, konsiderohen si lëndime me pasoja të përhershme në shëndet, e për më tepër të autorizuarit e palëve nuk kishin as pyetje e as vërejtje në këtë pjesë të ekspertizës.

Eksperti ortoped, në sqarimet e tij, ka theksuar se mbetet pranë ekspertizës dhe nuk ka dicka më shumë për të shtuar. Në pyetjet e të autorizuarit të palës së paditur lidhur me tronditjen e trurit të paditësit K., ka deklaruar se mendimin e kemi dhënë si në ekspertizë, duke u bazuar në shkresat e lëndës, e po ashtu edhe në bazë të ekzaminimit direkt të paditësit, ku diagnoza e vendosur në ditën e lëndimit nga mjeku specialist neurolog, ku janë bërë ekzaminime të CT dhe ekzaminime tjera, kemi ardhur në këtë përfundim. Terapia a vendosur në bazë të asaj që ka vlerësuar specialisti i fushës, është adekuate. Në pyetjen tjetër se çfarë është glaskovecomascale ose GSC dhe a është bërë ky ekzaminim për të konstatuar tronditjen trunore tek paditësi Kapllan, eksperti është përgjigjur se glascovsecomascale është parametër ndërkombëtar i vlerësimit të gjendjes së vetëdije, komunikimit dhe shikimit tek pacienti në momentin e ekzaminimit, ndërsa në rastin konkret, mjeku specialist kujdestar neurolog, shihet se e ka vendosur në bazë të ekzaminimit direkt të pacientit dhe vlerësimit të statusit neurologji. Në pyetjen e gjykatës, nëse të njëjtit mund të japin konstatimin lidhur me dëmtimet trunore të paditësit, janë përgjigjur se ne kemi mendimin e përbashkët sa i përket kësaj pike, por edhe në pikën 1.2.1 të kapitullit të parë të tabelës së BQK, është cekur në mënyrë decisive invaliditeti në shkallë prej 3% për tronditje trunore të verifikuar në institucione shëndetësore brenda 24 orëve.

Tutje, as e autorizuar e paditësit e as të paditurit, nuk kishin vërejtje në pjesën e ekspertit të ortopedisë.

Gjykata, kësaj ekspertizë e cila është paraqitë bashkërisht nga të dy ekspertët, i ka falur besimin në tërësi, pasi që e njëjta është përgatitur në mënyrë profesionale dhe i përgjigjet përgatitjes së ekspertëve, kurse të autorizuarit e palëve nuk kishin vërejtje në të, pasi që ekspertët kishin dhënë sqarimet e nevojshme.

Lidhur me këtë ekspertizë e po ashtu edhe me provat e tjera të administruara nga ana e gjykatës, asnjëri nga të autorizuarit e palëve në procedurë nuk kishte bërë vërejtje, andaj edhe gjykata ka vlerësuar se provat materiale e në veçanti ekspertiza nga lëmia e psikiatrisë dhe ortopedisë ishte e plotë dhe nuk kishte nevojë për sqarime shtesë nga ana e ekspertëve të fushave respektive.

Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) 04/L-077, rregullon çështjen e kompensimit të dëmit (material dhe jo material). Me nenin 136 par. të LMD-së parashihet se “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij: kurse me nenin 159 i LMD-së, parg.1 thotë: “Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë”. Me nenin 137 të LMD-së përcaktohet se: Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material). Kurse me dispozitën e nenit 183 par. 1 e LMD-së përcaktohet se Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. Prandaj gjykata duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material dhe jo material, posaçërisht duke marr parasysh natyrën dhe shkallen e dëmtimeve trupore të shkaktuar për paditësin, vlerësimin në ekspertizës mjekësore, gjykata miratoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve të bazuar e në vlerën e shpërblimit të dëmit si në piken **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se shumat e kompensimit të aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë adekuate, duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësve dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësoj paditësve satisfaksion që ata të jenë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensojnë të mirat jo materiale nga të cilat janë privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën ata do ta kishin po që se të njëjtat nuk do t'i kishin humbur, e krejt kjo duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre dhe kohën e nevojshme të shërimit. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit material dhe jo material, si dhe

në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cili i shërben ky kompensim, e gjithashtu kriteret e vëna nga praktika gjyqësore.

Në emër të ushqimit të përforcuar për paditësin K.K. gjykata ka caktuar kompensimin në shumën prej 210 € si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësi sipas mendimit të ekspertëve të mjekësisë si pasojë e aksidentit ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej tre javë – ushqim i pasur me vitamina dhe minerale, kurse për paditësen H.K. për gjykata ka caktuar kompensimin në shumën prej 70 € si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësi sipas mendimit të ekspertëve të mjekësisë si pasojë e aksidentit ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 7 ditë – ushqim i pasur me vitamina dhe minerale.

Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, për paditësen K.K., gjykata ka caktuar kompensimin në shumën prej 210 € si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësja sipas mendimit të ekspertëve të mjekësisë si pasojë e aksidentit ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e huaj për t'i kryer shumicën e aktiviteteve të përditshme jetësore në kohëzgjatje prej dy javë, kurse për paditësen H.K. gjykata ka caktuar kompensimin në shumën prej 112 € si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësja sipas mendimit të ekspertëve të mjekësisë si pasojë e aksidentit ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e huaj për t'i kryer shumicën e aktiviteteve të përditshme jetësore në kohëzgjatje prej një javë.

Gjykata për kategoritë e dëmit ushqim i përforcuar dhe ndihmë dhe kujdes i huaj, vlerëson se mund të caktohet edhe në mungesë të provave materiale, ngase është standard i ndërtuar tashmë nga praktika gjyqësore, dhe vështirë i argumentuar. Andaj me çmuarje të lirë dhe konform nenit 323 të LPK-së ka arritur në përfundim se shumat e gjykuara të shpërblimit të dëmit për këto kërkesa janë në përputhje me dëmin e pësuar sipas këtyre bazave.

Në emër të shpenzimeve të mjekimit për K.K. gjykata aprovoi shumën prej 6 €, ngase në shkresat e lëndës gjenden disa dëftesa, përmes së cilës se provohet se paditësi ka paguar shërbim për kontrollë në spital, të cilat dëftesa për nga data e lëshimit të tyre përgjigjet me kohën e lëndimit. Kurse është refuzuar pjesa e kërkesëpadisë që ka të bëjë me shpenzimet e tjera të shërimit, ngase nuk është arritur të argumentohet me prova se cilat kanë qenë shpenzimet e shërimit të paditësit, pra në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi për harxhimet e tilla. Sa i përket paditëses H. për këtë

kategori të dëmit material, gjykata aprovoi shumën prej 3 €, ngase në shkresat e lëndës gjenden disa dëftesa, përmes së cilës se provohet se paditësi ka paguar shërbim për kontrolla në spital, të cilat dëftesa për nga data e lëshimit të tyre përgjigjet me kohën e lëndimit.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet më dëmin material dhe jo material gjykata vendosi si në piken III të dispozitivit të aktgjykimit për paditësin K. dhe paditësen H., gjykata vlerësoi se kompensim përtej shumave të gjykuara, nuk do të ishin në harmoni me të mirën e shkelur dhe do të tejkalonte satisfaksionin real të cilin paditësit do ta realizojnë me këtë kompensim.

Duke qenë se pas administrimit të të gjitha provave, gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë, po ashtu ka vërtetuar se të paditësve u takon edhe kamatëvonesa, gjykata lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8 %, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhi të kryesor, edhe kamatën.” Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8 %) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, e llogaritur nga data e marrjes së aktgjykimit, gjegjësisht prej datës 16.04.2024 e gjerë në pagesën definitive, kurse për dëmin material nga data e parashtrimit të padisë me datë 28.12.2020 sepse bazuar në nenin 170 të LMD-së “Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit”. Sipas kësaj, kamata për dëmin material fillon të rrjedhë që nga momenti i parashtrimit të kërkesës për kompensimin e dëmit, sepse dëmi si i tillë, ka qenë i njohur që nga momenti i shkaktimit. Gjukata vendosi për kamatën prej 8% për faktin se pala e paditur, me datën 13.10.2021, i ishte përgjigjur me ofertë kërkesës së palës paditëse për kompensimin e dëmit, e në këtë rast nuk aplikohet kamata prej 12%.

Gjukata me rastin e vendosjes lidhur me kërkesëpadinë e paditësit, si fakt vendimtar me të cilën u përcaktua rrjedha e procedurës së kësaj çështje, fillimisht ishte fakti se pala e paditur nuk e ka kontestuar bazën e kërkesëpadisë, ashtu që gjykatës i kishte mbetur për të vërtetuar vetëm lartësinë, kur për vërtetimin e lartësisë për dëmin jo material, si provë vendimtare paraqitet ekspertiza nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë e cila ka shërbyer për vërtetimin e një fakti tjetër vendimtar e që është lartësia e kontestit, si dhe përmes së cilës është vërtetuar natyra dhe lloji i lëndimit për palën paditëse, e që më pas, përmes së njëjtës gjykata ka ardhur në përfundim se cili duhet të jetë kompensimi i drejtë për paditësit. Sa i përket dëmit material, gjykata lidhur me akordimin e kompensimit lidhur me ndihmën e personit të tretë dhe shpenzimeve për ushqim

të përforcuar, edhe në këtë rast si provë vendimtare paraqitet ekspertiza nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë, kurse akordimi i kompensimit u bë nga vlerësimi i lirë i gjykatës, bazuar në nenin 323 të LPK-së, ndërsa për shpenzimet për mjekim, si prova përcaktuese kishim dëftesat dhe faturat e paraqitura si prova.

Gjykata i vlerësoj dhe pretendimet e palës së paditur, por që të njëjtat nuk patën ndonjë rol për vendosje ndryshe të gjykatës, pasi që në përgjithësi pala e paditur, tërë kontestimin e saj e kishte në drejtim të lartësisë së kontestit, pasi që edhe në procedurë gjyqësore kishte ofruar ofertë për paditësin, kurse gjykata e gjendur para një sërë provash materiale të cilat i ka administruar, ka vlerësuar se kompensimi i akorduar si në dispozitiv, i përgjigjet më së miri apo thënë ndryshe, është kompensimi adekuat për paditësit për lëndimet e rënda që kanë pësuar si rezultat i aksidentit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrë konform nenit 449 dhe 452.2 të LPK-së dhe tarifës zyrtare për përfaqësime të OAK-së dhe atë si në vijim: për përpilimin e padisë 156 €, taksën për padi prej 31 euro dhe diferencën e taksës prej 71 euro, shpenzimet për ekspertizë mjeko ligjore në lartësi 500€, për katër seanca të mbajtura nga 202.80 euro, kurse pjesa tjetër e shpenzimeve është refuzuar si e pa bazuar, pasi që këto janë shpenzime proporcionale për suksesin e arritur në procesin gjyqësor ndërsa pjesën tjetër të shpenzimeve të kërkuara është refuzuar e pabazuar.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura dhe bazuar në nenin 142 par.1 dhe 2, 143.1 të LPK-së nenit 136 par.1, 137, 159 par.1, 170, 183 par.1 dhe nenit 382 të LMD-së dhe nenit 449 dhe 452.2 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2020:186032, C.nr.1731/20, Dt.16.04.2024

Gjyqtari  
Vegim Maloku

---

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.